




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike -
Ministarstvo za digitalizaciju i javnu upravu - Ministry of Digitalization and
Public Administration

INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE
INSTITUT KOSOVA ZA JAVNU ADMINISTRACIJU
KOSOVO INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION

Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) në bashkëpunim me Zyrën e Inspektorit të Përgjithshëm (ZIP), financuar dhe mbështetur nga GIZ, në bazë të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.13/2018 për Kushtet, Angazhimin, Kategorizimin dhe Mënyrën e Pagesës së Trajnerëve në IKAP, si dhe Rregullores (QRK) Nr.06/2025 për Trajnimin dhe Testimin e Detyrueshëm, si dhe Certifikimin e Inspektorëve të Republikës së Kosovës, shpall:

THIRRJE PËR APLIKIM

Ftohen të interesuarit të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi për trajnimin e trajnerëve, të aplikojnë për trajnerë të ardhshëm për zbatimin e këtij programi:

TpT për Trajnimin e Detyrueshëm të Inspektorëve

Ky program ka për qëllim përgatitjen dhe certifikimin e trajnerëve profesionistë për trajnimin e detyrueshëm të inspektorëve, në pajtim me UA Nr.13/2018 dhe Rregulloren Nr.06/2025. Programi synon të krijojë një trupë trajnerësh të aftë për të ofruar trajnime cilësore dhe të standardizuara për inspektorët e Republikës së Kosovës, duke siguruar që përmbajtja e trajnimit të jetë e miratuar nga ZIP-i dhe e certifikuar nga IKAP-i.

Pjesëmarrësit do të pajisen me njohuri të avancuara për kornizën normative të inspektimeve dhe metodologjinë e inspektimit të bazuar në rrezik, kompetenca profesionale për zbatimin korrekt të procedurave administrative dhe legjislative, aftësi pedagogjike dhe prezantuese për të udhëhequr sesione efektive të trajnimit, shkathtësi për planifikimin, dizajnimin dhe strukturimin e moduleve trajnuese, si dhe kompetenca për mentorim dhe mbështetje profesionale të inspektorëve gjatë punës së tyre.

Programi do të ndihmojë pjesëmarrësit të kuptojnë rolin dhe përgjegjësitë e inspektorëve, të hartojnë materiale trajnuese, të zhvillojnë sesione interaktive dhe të aplikojnë qasje moderne të trajnimit për të rritur. Vetëm pas certifikimit nga IKAP-i, trajnerët mund të ftohen për zhvillimin e trajnimeve të detyrueshme për inspektorë, sipas nevojës dhe rezultateve të vlerësimit, në bashkëpunim me ZIP-in.

Kohëzgjatja dhe koha e mbajtjes së programit të trajnimit

Trajnimi për Trajnerë (TpT) pritet të mbahet në muajin qershor 2026 dhe do të zgjatë shtatë (7) ditë.

Vlerësimi i kandidatëve:

Të gjithë kandidatët do të vlerësohen në bazë të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 13/2018 për kushtet, angazhimin, kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në IKAP.

Aplikacionet vlerësohen në bazë të kriterëve si në vijim:

- Arsimimi dhe kualifikimi profesional: (Juridik, Ekonomi, Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale apo Administratë Publike) të ketë të kryer të paktën nivelin master të studimeve (e preferuar);
- Përvoja e punës (së paku 5 vjet përvojë pune profesionale);
- Përvoja në trajnime (e preferueshme të kenë njohuri në fushën e inspektimeve);
- Elementet e tjera të meritës (pjesëmarrja në hartimin e legjislacionit, certifikatat, letër rekomandimi, njohja e gjuhëve të huaja etj.).

Angazhimi i trajnerëve pas trajnimit:

Kandidatet e certifikuar, do të angazhohen nga IKAP-i në programin e trajnimit të detyrueshëm për inspektorët, i cili organizohet në bashkëpunim me ZIP-in.

Afati kohor për dorëzimin e aplikacioneve: **07.05.2026 deri më 21.05.2026.**

Numri i kandidatëve që do të përzgjidhen për të vijuar trajnimin është i limituar në dhjetë (10).

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë biografinë e tyre / CV dhe një **letër motivimi** (deri në **400 fjalë**) në mënyrë elektronike në gjuhën shqipe.

Aplikimi bëhet në mënyrë elektronike në e-mail adresën: besart.mulaj@rks-gov.net duke specifikuar emërtimin e programit për të cilin aplikojnë.

Të gjitha kualifikimet dhe dëshmitë e përmendura në biografinë / CV tuaj mund të kërkohen për verifikim nga Komisioni vlerësues i IKAP-it.